



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROŠEVAC

P.nr.1862/17

NË EMËR TË POPULLIT

Më
Dana

30. 11. 2017

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, gjyqtari individual Mustaf Tahiri, me sekretaren juridike Drita Ujupi, në lëndën penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga fsh. [REDACTED], i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.1408-2/16 të dt.20.07.2017 për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e prokurorisë për dhënien e urdhrit ndëshkimor dënim me gjobë, gjykata me dt. 15.09.2017 mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTH-së në Ferizaj PP/II.nr.1408-2/16 të dt.20.07.2017 dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri [REDACTED], nga fsh. [REDACTED] Komuna e Feriazjt, i lindur më [REDACTED], nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED], e gjinisë [REDACTED], shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën mesme, me nr.personal të letërnjoftimit [REDACTED].

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datën 15.08.2016 rreth orës 16:30, në rrugën magjistrale, Kaçanik-Ferizaj, përkatësisht afër autoservisit "Shehu", në fshatin Gërlic komuna e Feriazjt, duke drejtuar automjetin transportues të markës "Man", me targë të regjistrimit [REDACTED], e duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 55/1 të LSKRR-së, nga pakujdesia duke mos mbajtur distancën e nevojshme të sigurisë, dhe nga ngarkesa me mjettë edhe pse frenon me pjesën e përparme e godet në pjesën e prapme të anës së djathtë automjetin e markës "VW Tuaron" me targa të regjistrimit Gjermane [REDACTED], të cilën e drejtonte [REDACTED], me të cilin rast pos dëmeve materiale lëndime të lehta trupore pëson [REDACTED], lëndime këto të përshkruara në ekspertizën mjeko-ligjore të datës 13.04.2017.

me ç 'rast ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4,7,17,23,41,46, dhe 73 të KPRK-së si dhe nenit 495, të KPP-së të pandehurin e :

G J Y K O N

Me dënim në gjobë në shumë prej 200 (dyqind) €, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rastë se dënimi me gjobë nuk mundë të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti do ti zëvendësohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1(një) ditë burg.

Të, dëmtuarit, [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] [REDAKTUAR], për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 90.88 € dhe paushallit gjyqësor shumën prej 20 € në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr.1408-2/16 të dt.20.07.2017 ka akuzuar të pandehurin [REDAKTUAR] për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe ka ushtruar kërkesë për dhënie të urdhrit ndëshkimor PP/II.nr.1408-2/16 të dt.20.07.2017 me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallximi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i pandehuri.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par 1.të KPPK-së.

Gjykata duke i shikuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës si: mendimi dhe konstatimi i ekspertit të komunikacionit rrugor, Valton Dervishi e datës 07.02.2017, mendimi dhe konstatimi i ekspertit mjeko-ligjor Dr. Naim Haliti të datës 13.04.2017, fotografitë dhe provat tjera që gjinden në shkresat e lëndës, me ç'rast Gjykata konstaton se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 463 par.2 të KPPRK-së, të dëmtuarit, [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale është marrë në baze të nenit 450 dhe 451 të KPPK-së dhe atë në shpenzime të procedurës penale shumë prej 90.88 dhe në emër të paushallit gjyqësore po ashtu shumë prej 20 €.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr. 1862/17 dt.15.09.2017

Sekretare Juridike

Drita Ujupi

Gjyqtari,

Mustaf Tahiri



UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi mundë të ushtrohet kundërshtim në afatin prej 8 (tetë) ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit, gjyqtarit individual të kësaj gjykate përmes kësaj gjykate. Pas kalimit të afatit për kundërshtim, urdhëri ndëshkimor merrë formën e prerë dhe dënimi i shqiptuar ekzekutohet.